




DISCOVER
— ITS BEAUTY —

Pjesa 3

ABC-JA E ISLAMIT

DR. NAXHI IBRAHIM



ABC-JA E ISLAMIT!

Islami na mëson, se rruga drejt një jete të lumtur, të kënaqur dhe të përjetshme është duke besuar Allahun, si Zoti i vetëm dhe të Dërguarin e fundit, Profetin Muhamed, dhe duke shqiptuar këtë dëshmi: **“Dëshmoj se nuk ka tjetër të adhuruar me meritë përveç Allahut, dhe dëshmoj se Muhamedi është i Dërguari i Allahut.”**

Islami na tregon gjithashtu thjesht se, të besuarit në Zot dhe në Profetët e Tij, nuk mjafton për të fituar paqen e shpirtit, lumturinë dhe shpëtimin! Ne duhet gjithashtu të zbatojmë urdhrat e Allahut duke adhuruar vetëm Atë, duke iu bindur urdhrave të Tij dhe duke bërë vepra të mira.

“Allahu u ka premtuar falje (të gjynaheve) dhe shpërblim të madh atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira.”
(Kur'ani, 5:9).

Nënshtimi ndaj vullnetit të Zotit është esenca e mesazhit të Allahut. Në Kuran, Allahu pohon kuptimin e vërtetë të nënshtimit dhe shpërblimit e përgatitur, për ata që besojnë dhe bëjnë punë të mira me këtë ajet: ***“Me të vërtetë, ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë për banesa kopshtet e Firdeusit.”***
(Kur'ani, 18:107)



ABC-JA E ISLAMIT!

Islami nënkupton nënshtrimin ndaj Vullnetit të Allahut, Zotit të Vetëm të Vërtetë. Kështu, të besuarit në Njëshmërinë e Zotit (Teuhidi), pra, të adhuruarit e Allahut pa i shoqëruar dikë në adhurim, bindja ndaj urdhëresave të Tij, dhe nënshtrimi ndaj Vullnetit të Tij janë esenca e mesazhit të Allahut që i është dërguar të gjithë Profetëve dhe të dërguarve. Kjo fjalë: ‘nënshtrim’ është kuptimi i fjalës në arabisht **‘ISLAM’**.


Meqenëse Profetët dhe të Dërguarit e Allahut (Zotit) predikuan të njëjtin mesazh, atëherë, feja e tyre po ashtu duhet të jetë e njëjtë! Kurani konfirmon se, ‘Islami’ (nënshtrimi ndaj Allahut) është feja e vërtetë e Ademit dhe Havasë dhe e pasardhësve të tyre deri në Ditën e Gjykimit. Kurani thotë:

“Me të vërtetë, feja e vetme e pranuar tek Allahu është Islami (nënshtrimi ndaj Zotit).” (Kur’ani, 3:19)

“Thuaj, Me të vërtetë, udhëzimi i Allahut është udhëzimi i vërtetë; dhe ne jemi urdhëruar t’i nënshtrohemi Zotit të botëve.” (Kur’ani, 6:71)

“A dëshirojnë ata fe tjetër pos fesë së Allahut (Islamit, nënshtrimit ndaj Zotit)? Ndërsa Atij i është nënshtroar gjithçka që ka në qiej e në tokë, me dëshirë ose pa dëshirë, dhe vetëm tek Ai do të kthehen.” (Kur’ani, 3:83)

“Thoni: “Ne besojmë në Allahun, në atë që na është shpallur neve (Kuranin), në atë që i është shpallur Ibrahimit, Ismailit, Is’hakut, Jakubit dhe Esbatëve (12 bijve të Jakubit), në atë që i është dhënë Musait e Isait dhe në atë që u është dhënë profetëve nga Zoti i tyre. Ne nuk bëjmë kurrfarë dallimi midis tyre dhe vetëm Allahut i përulemi”.” (Kur’ani, 2:136)



Çuditërisht, kuptimi i Islamit dallohet gjithashtu edhe në Bibël, e cila thotë:

“Nënshtrojuni Zotit dhe jeni në paqe me Të; në këtë mënyrë do të ju vijë mirëqenia.” (Job 22:21)

“Nënshtrojeni veten tuaj para Zotit.” (James 4:7)

Njëjtë, sikurse mësimet e Islamit, të cilat na tregojnë neve se besimi në Zot, pa bërë punë të mira dhe të drejta, nuk mjafton për të na siguruar shpëtimin dhe jetën e përjetshme (Parajsën), njofton Bibla:

“Unë, Zotit, i kërkoj zemrën dhe e hulumtoj mendjen, për t’i shpërblyer njerëzit sipas sjelljeve të tyre, sipas veprave të tyre.” (Jeremiah 17:10)

“E sheh që një person arsyetohet nga veprat dhe jo nga besimi i vetëm... Sepse për sa kohë që trupi pa shpirt vdes, ashtu edhe besimi pa vepra është njëlloj i vdekur.” (James 2:24; 26)

Njëjtë Bibla na njofton me këto fjalë të vëllait të Isait, Jakobit : ***“Sikurse trupi pa frymën është i vdekur, ashtu edhe besimi, pa vepra, është i vdekur.”*** (Jakobi, 2:26)

Myslimanët nuk mund të kenë besim në Allahun (në Zotin e vetëm të vërtetë) pa bërë punë të mira. Ata u binden urdhëresave, të cilat Isai a.s. dhe të gjithë Profetët i mësuuan dhe i zbatuan, sikurse është besimi në Zotin Vetëm, lutja, falja, gjuhëzimi dhe rënia në sexhde në adhurim, duke agjëruar, duke dhënë lëmoshë dhe duke bërë bamirësi, duke thënë “nëse Zoti dëshiron (InshaAllah)”, për një gjë që i përket të ardhmes dhe duke përdorur përshëndetjen e Isait a.s dhe të Profetëve, “paqja qoftë mbi ju (es-selamu alejkum)”.

Këto janë disa nga shembujt dhe pjesët e dëshmimeve, që qartazi tregojnë të vërtetën, unitetin dhe përbotshmërinë e kësaj feje madhështore dhe të bukur të të gjithë Profetëve: Islamin. Thënë praktikisht, një mysliman apo një person që dëshiron të bëhet mysliman, duhet të besojë apo të përmbushë gjashtë kushtet e besimit.



GJASHTË KUSHTET E BESIMIT NË ISLAM

1. Besimi në Allahun- në ekzistencën e Tij, në njëshmërinë e Tij (që në gjuhën arabe quhet teuhid), në sundimin e Tij, në emrat dhe cilësitë e Tij unike dhe se Ai është i vetmi që meriton të adhurohet.

Ajetet (citatat) e Kuranit të Madhërishëm dhe thëniet e Profetit, na kanë mësuar emrat dhe cilësitë e Allahut, Zotit të vërtetë, që është një. Ne asnjëherë nuk mund ta përfshijmë madhështinë e Allahut, por sa më shumë që e njohim Atë, aq më shumë do ta duam dhe do ta adhurojmë Atë. Më poshtë janë vetëm disa nga emrat dhe cilësitë e Allahut: Allah (emri kryesor i Zotit), Zoti, i vetmi Zot i vërtetë, i Mëshirshëm, Mëshiruesi, Krijuesi, Sunduesi, i Shenjti, i Pastërti, i Bekuari, Burimi i Paqes dhe i Përsosmërisë, Gjykesi, i Gjithëdijshmi, Shikuesi, Dëgjuesi, i Madhi, Falësi, më i Larti, Madhështori, më i Dashuri, më i Buti, Furnizuesi, i Vërteti dhe i Durueshmi.

Profeti Muhamed (paqja qoftë mbi të) thotë: “Cilësitë e plota të bukurisë dhe përsosmërisë, i përkasin Allahut. Me të vërtetë, Allahu është i Bukur dhe e do bukurinë”.

2. Besimi në engjëjt e Allahut, të cilët i ka krijuar që ta adhurojnë Atë dhe t'i binden Atij, duke i zbatuar urdhrat e Tij.

3. Besimi në shpalljet e Allahut, duke përfshirë fjalën origjinale të Allahut, që i është shpallur Musait dhe Isait (jo shkrimet e njerëzve dhe tregimet e rrëfyera nga autorë të ndryshëm që gjenden në Biblën e ditëve të sotme). Kurani i Madhërishëm është fjala e fundit, e pastër dhe autentike e Zotit që i është shpallur Profetit Muhamed.

الله



GJASHTË KUSHTET E BESIMIT NË ISLAM

4. Besimi në të Dërguarit dhe Profetët e Allahut, duke përfshirë Ademin, Nuhun, Musain, Jahjain, Isain dhe Muhamedin. Në fakt, një mysliman nuk është besimtar i vërtetë nëse ai apo ajo nuk beson në Musain dhe Isain (dhe të tjerët), si Profetë të dërguar nga Zoti i vërtetë (Allahu), Krijuesi.

5. Besimi në Ditën e Gjykimit dhe në llogaridhënie. I gjithë njerëzimi do të gjykohet nga Allahu, në bazë të besimit dhe të veprave të tyre. Pas këtij gjykimi, ata që kanë besuar do të pranohen në jetën e lumtur e të përhershme, në Xhenet, ndërsa ata që nuk kanë besuar në Allahun, dhe nuk kanë bërë vepra të mira, dhe ju kanë kundërvënë urdhëresave të Zotit, ata do të hidhen në Xhehenem. (Allahu na ruajtë dhe na shpëtoftë nga Zjarri dhe na dhuroftë jetën e përhershme në Xhenet!)

6. Besimi në kader, në caktimin e Allahut dhe në diturinë e Tij absolute për të gjitha gjërat.

Meqenëse besimtarët besojnë në Allahun, ata janë të kënaqur, të lumtur dhe i besojnë Allahut për gjithçka, që ka caktuar për ta, edhe nëse ata e perceptojnë atë të mirë ose të keqe. Ata mundohen të mos dëshpërohen apo të bëhen të pashpresë e të brengosur kur ndodhin krizat dhe vështirësitë. Në vend të kësaj, ata mundohen të bëjnë gjithçka që munden për ta përmirësuar situatën e tyre, por në fund kthehen tek Allahu për ndihmë, mbështetje dhe shpërblim. Ky besim i bukur në Allahun dhe në caktimin e Tij, i sjell myslimanit qetësi të mendjes dhe kënaqësi pavarësisht agresivitetit, cënimit, zotërimit dhe shfrytëzimit të tokës apo pasurisë së tij, si shkelje që ndodhin sot në botë dhe pavarësisht padrejtësisë, paragjykimit, diskriminimit apo shpifjeve, nga të cilat ai dhe të tjerët vuajnë.



PESË SHTYLLAT E ISLAMIT

Përveç kushteve të besimit, Islami na mëson, po ashtu ta kthejmë këtë besim në praktikë. Krahas bërjes së punëve të mira në përgjithësi, myslimanët duhet të praktikojnë pesë shtyllat e Islamit, të cilat janë:

1. Shehadeti (dëshmia e besimit)

Kjo dëshmi është shtylla themelore dhe porta e Islamit. Ajo është:

“Dëshmoj, se nuk ka Zot tjetër, që meriton të adhurohet pos Allahut, dhe dëshmoj se, Muhamedi është i Dërguari i Allahut”.



Në gjuhën arabe lexohet kështu:

**ESH-HEDU EN LA ILAHE IL-LA ALLAH,
UE ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDEN RESULALLAH!**

Kjo është dëshmia, që një njeri duhet të thotë në mënyrë që ta pranojë Islamin. Ajo përfshin të vërtetën, bukurinë dhe thjeshtësinë e Islamit.

2. Namazi

Shtylla e dytë e fesë islame është falja e pesë namazve obligative. Këto rituale lutjesh përfshijnë qëndrimin në këmbë, përlulen dhe sexhden, recitimin e pjesëve të Kuranit, madhërimin dhe përmendjen e Allahut dhe kërkimin e mëshirës së Tij, faljen dhe Xhenetin.



PESË SHTYLLAT E ISLAMIT

Bukuria dhe fuqia e këtyre lutjeve sjell lartësim shpirtëror, rehati psikologjike, mbështetje si dhe lehtësim, qetësi dhe kënaqësi për shpirtrat, mendjet dhe zemrat tona. Mënyra se si lutjet janë të shpërndara gjatë ditës dhe natës do të thotë se ne jemi gjithmonë duke e përmendur Zotin (Allahun).

Ajo që i shton bukurinë namazit është fakti se Profetët e Zotit, duke përfshirë Ademin, Nuhun, Ibrahimin, Musain, Isain dhe Muhamedin, gjithashtu janë lutur dhe kanë rënë në sexhde para Zotit të vetëm të Vërtetë, Allahut. Me fjalë të tjera, myslimanët i ndjekin hapat e atyre Profetëve dhe të Dërguarve të Zotit. Për më tepër, shumë koncepte të tjera të bukura, sikurse dashuria ndaj Zotit, nënshtrimi dhe dorëzimi ndaj Tij, lutja, uniteti, barazia, sinqeriteti, durimi, përulja dhe butësia manifestohen dhe mësohen po në këtë namaz. Në të vërtetë, lutja e sinqertë, dhikri (apo përmendja e Allahut), istigfari (kërkimi i faljes) dhe duaaja (lutja) ndaj Allahut, vetëm janë çelësa të thellë dhe të mrekullueshëm për paqe mendore, qetësi dhe bereqet.

3. Zekati (lëmosha)

Zekat quhet dhënia obligative e një sasive të caktuar të pasurisë, të varfërve dhe atyre që kanë nevojë. Zekati e pastron pronën dhe pasurinë dhe në të njëjtën kohë na pastron nga lakmia dhe koprracia. Ai na mëson kujdesin dhe ndarjen e gjërave së bashku, gjë që ndërton ura të forta të dashurisë dhe respektin e përbashkët mes të pasurve dhe të varfërve. Në të vërtetë, zekati na edukon në mbështetje, ndihmë, bashkëpunim dhe solidaritet për tërë shoqërinë.



PESË SHTYLLAT E ISLAMIT

4. Agjërimi

Agjërimi nënkupton shmangien e të gjitha ushqimeve, pijeve dhe marrëdhënieve martesore nga lindja e diellit e deri në perëndim gjatë muajit të Ramazanit. Disa nga dobitë e bukura dhe mësimet e agjëritimit, përfshijnë:

- Dobitë shpirtërore: Ne zhvillojmë takvanë (devotshmërinë) dhe sinqeritetin. Agjërimi i muajit të Ramazanit ofron mundësinë e mrekullueshme për ne, që të arrijmë mëshirën dhe faljen e Zotit, ruajtjen nga Zjarri dhe fitimin e jetës së përhershme në Xhenet.
- Dobitë morale dhe emocionale: Në shkollën e Ramazanit (agjëritimit), ne mësojmë dhe përjetojmë urinë, që miliona njerëz në pjesë të ndryshme të botës përjetojnë pa vullnetin e tyre. Kjo na frymëzon të ndajmë gjëra, të tregojmë empati ndaj tyre dhe të jemi modestë, bujarë dhe të mirësjellshëm.
- Dobitë edukative: Agjërimi na mëson shumë mësimet. Për shembull, ne e shohim se është e mundur të heqim dorë nga shprehitë e këqija, sikurse është ngrënia e tepruar. Agjërimi, gjithashtu na disiplinon sjelljen dhe na trajnon të jemi të durueshëm dhe të përmbytur. Për më tepër, na kujton se Profetët e Zotit, si Muhamedi, Musai dhe Isai gjithashtu agjëronin.
- Dobitë shëndetësore: Përmes agjëritimit, trupi largon toksinat dhe yndyrnat e tepërta. Doktorët dhe nutricionistët shpesh e rekomandojnë agjërimin, duke e përshkruar si një 'djegës mbeturinash' dhe si 'terapi shëruese' dhe është miratuar si ilaç për shumë sëmundje.



PESË SHTYLLAT E ISLAMIT

5. Haxhi

Haxhi është pelegrinazhi (udhëtimi i gjatë) në Mekë, që çdo mysliman duhet ta praktikojë një herë në jetën e tij apo saj, për aq kohë sa ai apo ajo është në gjendje të mirë fizike, mendore dhe financiare ta bëjë këtë gjë.

Sikurse me shtyllat e tjera dhe parimet e Islamit, bukuritë, mësimet dhe dobritë e haxhit janë të shumta. Miliona besimtarë të të gjitha gjuhëve dhe racave nga e gjithë bota i përgjigjen thirrjes së Profetit Ibrahim. Konceptet dhe parimet e mrekullueshme mund të shihen në praktikë gjatë haxhit, duke përfshirë: nënshtrimin dhe bindjen ndaj Allahut, vëllazërinë dhe lidhjen e motrave në Islam, unitetin, durimin, sakrificën, lutjen, bamirësinë dhe agjërimin. Haxhi vjetor dëshmon dhe karakterizon tubimin ose grumbullimin më të madh dhe më të veçantë fetare të llojit të vet në botë.

Gjatë kësaj përvoje të mrekullueshme të të gjitha racave dhe ngjyrave, të gjithë duke i shërbyer një Zoti dhe një mesazhi të vetëm, Malcolm X dhe të tjerë kanë zbuluar bukurinë e besimit të vërtetë, vëllazërinë dhe lidhjen mes motrave islame dhe barazinë mes tyre.



PESË SHTYLLAT E ISLAMIT

Haxhi më ka zgjeruar horizontin tim. Më ka bekuar me kuptim të ri. Për dy javë sa isha në Tokën e Shenjtë, pashë çka asnjëherë nuk kam parë për 39 vite këtu, në Amerikë. I pashë të gjitha racat, të gjitha ngjyrat, nga bjondët sykaltër deri tek afrikanët me lëkurë të zezë, të gjithë vëllezër të vërtetë! Në unitet! Duke jetuar si një! Duke adhuruar si një! (Autobiografia e Malcolm X).



EMRAT DHE TERMAT BAZIKË ISLAMË

Allah: Në gjuhën arabe, emri Allah është emri kryesor i Zotit të vërtetë, Krijuesit. Islami na mëson se, Allahu është Zoti i vërtetë i gjithë njerëzimit. Arabët, hebrenj dhe të krishterë e përdorin po kështu, këtë emër (Allah) për t'iu referuar Zotit dhe kjo fjalë përdoret për Zotin në Biblat e shkruara në gjuhën arabe.


Muhamed: Profeti i fundit i Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), ashtu siç i është shpallur Muhamedit.

Kurani i Madhërishëm: Fjala e Allahut, Zotit të Vërtetë, që i është shpallur Profetit Muhamed, nëpërmjet Xhibrilit.

Islami: Nënshtrim ndaj vullnetit të Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), Krijuesit.

Myslimani: Ai që i nënshtrohet vullnetit të Zotit të vetëm të vërtetë (Allahut), Krijuesit.

Xhamia (Mesxhidi): I referohet një vendi të pastër të përkuljes (sexhdes) që përdoret nga myslimanët kryesisht për lutje dhe adhurim.



DËSHMIA E BESIMIT HYRJA NË ISLAM

“Dëshmoj, se nuk ka Zot tjetër, që meriton të adhurohet pos Allahut, dhe dëshmoj se, Muhamedi është i Dërguar i Allahut.”

Në arabisht lexohet:




Që në shqip tingëllon sikurse më poshtë:

**ESH-HEDU EN LA ILAHE IL-LA ALLAH,
UE ESH-HEDU ENNE MUHAMMEDEN RESULULLAH!**



Kjo është dëshmia e besimit, që një njeri duhet ta shqiptojë në mënyrë që ta përqafojë Islamin; ajo e përmbledh të vërtetën, bukurinë dhe thjeshtësinë e Islamit.



DISCOVER

— ITS BEAUTY —

WWW.DISCOVERITSBEAUTY.COM



Scan it!

GLOBAL ACADEMY FOR TRANSLATION AND EDUCATION (GATE)
LONDON | THE UNITED KINGDOM

كتاب أبجديات الإسلام باللغة الألبانية